



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 57
Prishtinë, më 26. 05. 2010, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për Integritet Evropian

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini dhe Nait Hasani.

Munguan: Džezair Murati, Naser Rugova dhe Petar Miletiq.

Me ftesë: Bajram Rexhepi, Ministër i Punëve të Brendshme.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Besart Mustafa- praktikant, përfaqësues nga OSBE, KDI, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Integritetit Evropian, Ambasada Britanike dhe Zyra e Presidentit.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të 14. 04. 2010, 19. 04. 2010, 22. 04. 2010 dhe 05. 05. 2010,
3. Prezantimi i Ministrit të Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për financimin e subjekteve politike, me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së,

7. Shqyrtimi i Projektkodit të drejtësisë për të mitur, me amendamentet e Komisionit Funkcional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së,

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore, me amendamentet e Komisionit funksional, në aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE - së,

9. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

Kryesuesja propozoi që të fillojnë me pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Prezantim i Ministrit të Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi.

Kryesuesja -Tha se e dimë që hartimi i Raportit të Progresit bazohet në implementimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian nga institucionet e Kosovës, ku secila ministri ka të caktuar detyrat dhe përgjegjësit që duhet t'i përmbushin. Andaj ju kemi ftuar që të prezantoni para Komisionit për të arriturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme në përmbushjen e këtyre sfidave, si dhe të arriturat në luftë kundër krimit të organizuar, e veçanërisht luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

E ftoi Ministrin që t'i prezantojë të arriturat e kësaj ministrie.

Bajram Rexhepi, ministër – Menjëherë shprehu gatishmërinë të raportojë para Komisionit lidhur me të arriturat e kësaj ministrie në përmbushjen e sfidave që kanë dalë nga Raporti i Progresit, madje sa herë që Komisioni e konsideron të nevojshme. Si prioritet primar tha kemi sundimin e rendit dhe ligjit, pastaj prioritetin e liberalizimit të vizave, i cili është pjesë e procesit të integritetit evropian. Njoftoi se kanë përgatitur Raportin lidhur me përmbushjen e sfidave dhe të cilin raport do t'ia dorëzojnë Ministrisë së Integritetit Evropian. Tha presim që në ndërkohë të përmbushim edhe disa nga sfidat të cilat kanë dalë për Ministrinë, siç është procedimi i pakos ligjore që duhet për procesin e liberalizimit të vizave. Sa i përket procedimit të Pakos ligjore kërkoj nga anëtarët e Komisionit që të llojnë për procedimin sa më të shpejtë të këtyre ligjeve, sepse është me rëndësi që të arrihet dinamika e cila është paraparë. Tha është afër përfundimit Ligji për të Huajt dhe Ligji për Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Sa i përket menaxhimit të kufijve tha ka nevojë për investime kapitale, qoftë për vendosje të kamerave, qoftë për një datë bazë më të mirë. Me 15 prill është proceduar ligji për Ripranim, i cili ligj është i thjeshtë dhe fleksibil dhe i cili së shpejti do të miratohet, sepse është i koordinuar mirë me Komisionin Evropian. Njoftoi se sot është proceduar në Qeveri Strategjia për Riintegrim. Në këtë Strategji tha janë të përfshira një pjesë e ministrive, si dhe nivelet lokale. Njoftoi se deri më tani kanë nënshkruar marrëveshje për Ripranim me pesë shtete, ndërsa me pesë shtetet e tjera janë në fazën përfundimtare. Tha nuk është e domosdoshme të arrihet marrëveshje Riipranimi me të gjitha shtetet e BE - së. Arsye pse po procedohet në këtë mënyrë me secilin shtet veç e veç për arrijten e marrëveshjeve është mos njohja e Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE –së, sepse në të kundërtën do të kërkonin nga Komisioni Evropian që të bënin një marrëveshje të tillë me shtetet anëtare të BE - së. Lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore tha është një luftë permanente. Sa i përket policisë tha kemi ngritje të kapaciteteve dhe ka filluar t'i marrë përgjegjësit nga KFOR - i, ku nga resurset e brendshme të Policisë janë rekrutuar 187 policë për menaxhim të kufijve, sepse nuk është e lejuar rekrutim i numrit shtesë. Kontrollin e kufirit me Maqedoninë tha mendojmë ta marrim deri në fund të vitit, mirëpo nuk mund të merret komplet menaxhimi, sepse nuk kemi kapacitetet e mjaftueshme, ndërsa me Malin e Zi tha presim të kemi një takim të përbashkët deri në fund të vitit, ku pritet definimi i disa çështjeve dhe ngritjes së bashkëpunimit, me Serbinë për shkaqe politike mbetet kontrolli i kufirit së bashku me KFOR - in. Jemi të përkushtuar që të luftohet çdo formë e kriminalitetit. Është për t'u krenuar puna që është bërë në këtë tremujor, sepse gjatë kësaj periudhe kemi të arritura më të mëdha se sa gjatë gjithë periudhës prej vitit 2008. Njoftoi se sot ka qenë një takim për koordinim më të mirë në mes departamenteve të ndryshme konkretisht prokuroria, gjyqësia që me këto kapacitete që janë të

arrihet një sukses sa më i madh. Bashkëpunimi shumë i mirë i Policisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë ka rezultuar me kapjen e shumë trafikimeve të drogës dhe forma të tjera të krimit të organizuar.

Kryesuesja - Tha gjatë vitit 2008 është hartuar Strategjia dhe Plan i Veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga ana e Qeverisë dhe ajo Strategji është dashur të fillojë zbatimin në vitin 2009. Ju nuk potencuat që është bërë ndonjë veprim, siç ka qenë p. sh. nënshkrimi i protokolleve ndërshtetërore për kontrollin e trafikimit të qenieve njerëzore ndërmjet Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Ky bashkëpunim kryesisht po bëhet në baza ditore. Parlamenti ka debatuar lidhur me vjedhjen e drogës dhe provave në Dhomën e Policisë, mirëpo deri më tani nuk kemi as një informatë, andaj deshi të dinte më shumë rreth këtij rasti. Po ashtu tha e dimë se trafikimi i qenieve njerëzore në masë më të madhe bëhet me femra, prandaj në Planin e Veprimit është paraparë që këtyre femrave të trafikuar tu sigurohet integrimi në shoqërinë kosovare me një lloj page si subvencionim për to, që t'u mundësohet një jetë normale në shoqëri.

Ministri - Sa i përket luftimit të krimit të organizuar për të gjitha format e tij tha se ekzistojnë Strategjitë dhe të cilat janë në implementim e sipër dhe ekzistojnë njësi të caktuar që merren me këto çështje. Sa i përket protokolleve me Shqipërinë janë nënshkruar më herët marrëveshje bashkëpunimi dhe tani implementohen në baza ditore. E njëjta gjë tha do të ndodh edhe me Maqedoninë por më të ka qenë një memorandum dhe tani mund të ngrihet në nivel marrëveshjeje. Lidhur me rastin e vjedhjes së dëshmive dhe drogës në Dhomën e Policisë tha hetimet kanë filluar më shumë se një vit, ndoshta për shkak të kapaciteteve të limituara dhe vjedhjes së sofistikuar që ka qenë, rasti është tek EU-LEX - i, andaj informata e vetme që kam është se hetimet janë në një pistë të hetimit dhe janë duke vazhduar. Tha kam kërkuar që në momentin që të përfundojnë hetimet të na informojnë. Krenohem për të arriturat në javën e kaluar, por jam kritik edhe për dështimet. Tha kam qenë kritik për rastin e tentim arrestimit të Albin Kurtit, sepse ka pasur shmangie prej planit.

Njomza Emini - Tha ju krenoheni me tri rastet e fundit të luftimit të krimit të organizuar, mirëpo ka edhe shumë raste të krimit të organizuar të cilat nuk janë hetuar. Andaj pyeti çka keni ndërmarrë konkretisht për luftimin e krimit të organizuar.

Ministri - Tha nuk janë vetëm këto tri raste e fundit të cilat i përmenda si të arritura, por kemi edhe shumë raste të tjera të luftimit të krimit të organizuar. Tani tha kemi një qasje tjetër më të re dhe më të strukturuar. Ne tha presim që çdo ditë policia të veprojë në mënyrë edhe më të mirë dhe nëse vazhdojmë me këtë tempo do të kemi policinë më efikase në rajon. Tani tha kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Prokurorinë e Kosovës dhe me Ministrin e Drejtësisë, andaj në të ardhmen presim rezultate edhe më të mira.

Nait Hasani - Tha për mua ka qenë i papranueshëm tentimi i arrestimit të Albin Kurtit gjatë ceremonisë së varrimit të Ali Aliut, atdhetarit të Kosovës, i cili ka vuajtur burgun nga vitet e '60 - ta. Përdorimi i gazit lotsjellës ndaj popullatës është një krim të cilin e ka bërë policia ndaj qytetarëve. Po ashtu tha ka qenë e papranueshme edhe deklarata e juaj që keni bërë në vizitën në Maqedoni. Atje u vranë dy dhe u arrestuan të tjerët, sepse ju keni pranuar një listë ku autoritetet maqedonase thonë se ju kanë dorëzuar një listë me emrat e personave, ndërsa ju e mohoni një gjë të tillë. Ne tha nuk duhet të shkojmë për vizita në raste të tilla të ndjeshme. Sa i përket Raportit të shkruar të cilin e keni dorëzuar sot para Komisionit tha është një raport i përciptë dhe nuk i ngjan Raportit, sepse nuk jeni ju përgjegjës për kualifikimin e veprave të kryera, por janë organet e drejtësisë, prokuroria dhe gjyqësia. Ndërsa sa i përket rastit të Albin Kurtit tha dikush nga policia duhet të merret në përgjegjësi.

Ministri - Sa i përket tentim arrestimit tha jam deklaruar edhe më herët ku kam shprehur keq ardhjen publike. Planin i cili mua më është prezantuar ka qenë që Albin Kurti as në Akademinë përkujtimore, as në ceremoninë e varrimit të mos arrestohet. Ka qenë urdhër i trupit gjykues dhe prokurorit që të bëhet arrestimi dhe policia është segment zbatues i urdhrave të trupit gjykues. Se sa ka qenë i drejtë ky veprim tha kam biseduar me EULEX - in dhe kam kërkuar që edhe policia

duhet të tregojë profesionalizëm. Pranoj se ka pasur shmangie të Planit. Lidhur me dështimet që janë bërë tha janë hap procedurat dhe dikush do të përgjigjet. Policia nuk është trup statik, sepse nëse dikush sulmon ata duhet të reagojnë. Vetëvendosja tha ka strategji edhe në rastet kur nuk reagon policia dhe është shumë e kujdesshme kanë strategji të shkaktojnë incident dhe të dalin në rolin e viktimës për të fituar poena politikë, pra është çështje e strategjisë së tyre. Ne tha nuk duhet të nisemi dhe të shohim policinë si sinonim i së keqes, sepse policia mundohet me qenë demokratike dhe ne duhet të lirohemi nga ato ngjarje të së kaluarës. Policia tha nuk ka përdorur gaz lotsjellës, por sprej lotsjellës si formë e veprimi dhe se a ka qenë tejkualuar a jo Inspektorati i Policisë i jep këto vendime. Tha kam kërkuar që në çdo aksion ku ka përdorim të forcës të kemi vlerësim se a është tejkualuar a jo dhe të mos kemi gabime të tilla. Sa i përket deklaratës në Maqedoni tha unë zbatoj politikën shtetërore, sepse për ne është me rëndësi bashkëpunimi rajonal dhe siguria në rajon. Tha unë kam kërkuar që informimi duhet të jetë i menjëhershëm dhe jo të informohemi nga mediat për atë se çka ka ngjarë në Maqedoni, që Kosova të mos shihet si burim i dhunës dhe eksportues i armëve, kam qenë shumë i qartë. Qeverinë e Maqedonisë tha e kanë zgjedh qytetarët e saj, e jo ne. Ne tha jemi të përkushtuar dhe do të luftojmë çdo formë të trafikimit ilegal. Ne Maqedonisë i ndihmojmë nëse Kosova është shtet i fortë dhe ka nivel të lartë të sigurisë. Sa i përket listës na është thënë që është një listë e personave që janë të dyshuar. Drejtori i Policisë së Maqedonisë ka tentuar që të na japin atë listë, por ne kemi refuzuar dhe kemi kërkuar që ajo listë të vijë në mënyrë zyrtare. Ajo listë ne na është dorëzuar më datën 19 të këtij muaji. Atë listë e kam përcjellë te hetuesia, ku në të janë paraqitur 70 persona dhe shumica prej tyre janë të dyshuar për vjedhje dhe plaçkitje, ndërsa 15 % për vrasje. Ata të dyshuar mund të jenë në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri ose Preshevë. Ne do të angazhohemi maksimalisht, sepse nëse ata kanë bërë vjedhje në Maqedoni, të njëjtën gjë do ta bëjnë edhe në Kosovë.

Kryesuesja – Tha se ju s'e keni nënshkruar marrëveshje riatdhesimi me pesë shtete, pyeti a ka Qeveria ndonjë plan për të integrimin e tyre, sepse në të kundërtën ata do të jenë kriminelë potencial?

Ministri - Tha se sot është proceduar Strategjia për Riintegrimin e personave të riatdhesuar. Me këtë Strategji çdo gjë është e precizuar dhe është paraparë kostoja financiare për të gjitha veprimet. Para kthimit tha ne njoftohemi nga Qeveritë e vendeve dhe na i dërgojnë listat e personave të cilët do t'i kthejnë. Listat i marrim për verifikim nëse janë qytetarë të Kosovës, pas dy - tri javësh i kthejmë mbrapa këto lista dhe me nën protokolle akordohemi për dinamikën e kthimit. Nga 14 mijë e 900 persona, shumica janë të komuniteti RAE, ndërsa një pjesë e tyre mund të mos jenë qytetarë të Kosovës. Kam insistuar për kategorinë e nxënësve të cilët kanë filluar shkollën në gjuhën përkatëse të shtyhet kthimi i tyre dhe të mbesin me njërin prind deri në përfundimin e shkollës, sepse kthimi i tyre në kurikulat tona të arsimimit për ta do të jetë një psiko traumë, andaj jemi duke lobuar për këtë çështje. Kemi një mundësi që të shfrytëzohen shtëpitë e ndërtuara për komunitetin RAE të cilët nuk i kanë shfrytëzuar këto shtëpi.

Kryesuesja – Tha se deshi të dijë për pasaportat biometrike dhe softuerin në kufi për leximin e pasaportave, sepse janë kusht për liberalizimin e vizave.

Ministri – Tha se edhe pasaportat gjysmëbiometrike që i kemi tani lexohen në çdo vend kufitar edhe në Evropë, andaj kjo nuk paraqet ndonjë problem. Për të ardhur te pasaportat biometrike duhet të përmbushen parakushtet e që është regjistri civil. Kjo është kërkesa kryesore të cilën shpresojmë që nga gjashtë deri në nëntë muaj ne do ta përmbushim. Njoftoi se ekipet e Ministrisë, së bashku me ekipet e EULEX - it kanë dalë në terren për të parë kushtet dhe për të ndihmuar aty ku duhen me pajisje. Tha z. Fyle na ka rekomanduar që të punojmë ngushtë me Shqipërinë për të marrë si model se si duhet të punohet në këtë drejtim, sepse Shqipëria është shembulli më i mirë. Po ashtu tha kemi mbështetjen e plotë të Shqipërisë për të na ndihmuar në të gjitha mënyrat dhe me të gjitha mjetet. Njoftoi se janë hapur procedurat e tenderimit për pasaporta biometrike. Ne tha deri në fund të vitit mund të dalim simbolikisht me pasaporta biometrike dhe në të njëjtën kohë të mbushet regjistri civil. Tha kemi garanci edhe nga z. Fyle se edhe pesë shtetet të cilat nuk na kanë njohur, sa i përket procesit të liberalizimit të vizave nuk do

të bëjnë pengesa. Ne tha duhet të dimë se procesi i liberalizimit të vizave është më shumë proces teknik.

Kryesuesja e falënderoi Ministrin për prezantimin.

Kryesuesja kërkoi që për shkak të mungesës së kuorumit pikat e tjera të rendit të ditës të shtyhen për mbledhjen e ardhshme të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi